

VENDIM
Nr. 515, datë 1.8.2024

**PËR PËRCAKTIMIN E KOEFICIENTIT TË INDEKSIMIT TË BAZËS SË
VLERËSUAR TË VITIT 2022, PËR LLOGARITJEN E PENSIONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit 2022, me indeksin 13.5%, të llogaritur sipas kritereve të përcaktuara në nenin 59, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Indeksi i përcaktuar sipas pikës 1, të këtij vendimi, aplikohet për rivlerësimin e bazës së vlerësuar të arritur nëpërmjet kontributeve të derdhura dhe rivlerësimeve të tyre, të kryera deri në vitin 2022, dhe zbatohet për efekt të llogaritjes së shumës fillestare mujore të pensioneve, që do të caktohet me datë fillimi nga data 1 korrik 2024 e në vazhdim.

3. Indekset akumulative të bazës së vlerësuar, të arritur nëpërmjet pagave të periudhës 1994–2022, referuar kontributeve të derdhura sipas muajve në këtë periudhë dhe pagave referuese sipas punëve dhe profesioneve, e përcaktuar me vendimin nr. 561, datë 12.8.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e pagave referuese për llogaritjen e pensioneve”, të ndryshuar, sipas viteve, janë sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Pas aplikimit të indeksit të vitit 2022, baza e vlerësuar për efekt të llogaritjes së shumës fillestare mujore të pensioneve, që do të caktohen me datë fillimi nga data 1 korrik 2024, nuk mund të jetë më e lartë se:

a) trefishi i pagës minimale në shkallë vendi, e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, për pagat e periudhës nga viti 1994 deri në 31.12.2001;

b) paga maksimale në shkallë vendi, e përcaktuar sipas kritereve të nenit 10, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për pagat nga viti 2002 e në vazhdim.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, lidhen me zbatimin e formulës së caktimit të pensioneve, aplikohen vetëm për pensionet që caktohen me datë fillimi nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi e në vazhdim dhe përballohen brenda buxhetit vjetor, të miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2024.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Shtojca 1

Tabela e koeficienteve akumulative të indeksimit të bazës së vlerësuar	
Për pagat referuese deri më datë 31.12.1993	12.257
Për pagat e vitit 1994	12.257
Për pagat e vitit 1995	9.864
Për pagat e vitit 1996	7.653
Për pagat e vitit 1997	7.653
Për pagat e vitit 1998	6.395
Për pagat e vitit 1999	5.190
Për pagat e vitit 2000	4.727

Për pagat e vitit 2001	4.044
Për pagat e vitit 2002	3.735
Për pagat e vitit 2003	3.343
Për pagat e vitit 2004	3.037
Për pagat e vitit 2005	2.758
Për pagat e vitit 2006	2.504
Për pagat e vitit 2007	2.393
Për pagat e vitit 2008	2.113
Për pagat e vitit 2009	1.944
Për pagat e vitit 2010	1.861
Për pagat e vitit 2011	1.791
Për pagat e vitit 2012	1.723
Për pagat e vitit 2013	1.651
Për pagat e vitit 2014	1.651
Për pagat e vitit 2015	1.427
Për pagat e vitit 2016	1.427
Për pagat e vitit 2017	1.399
Për pagat e vitit 2018	1.350
Për pagat e vitit 2019	1.318
Për pagat e vitit 2020	1.281
Për pagat e vitit 2021	1.236
Për pagat e vitit 2022	1.135
Për pagat e vitit 2023	1.000
Për pagat e vitit 2024	1.000